



Universiteti Politeknik i Tiranës

Nr. 476 Prot, datë 07.05.2020



Akademia "IVODENT"

Nr. 313 Prot, datë 07.05.2020

MARRËVESHJE

PËR

BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT

SHKENCOR

NDËRMJET

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

DHE

AKADEMISË "IVODENT"

Universiteti Politeknik i Tiranës, i përfaqësuar nga Rektor Prof. Dr. Andrea Maliqari, dhe Akademia "IVODENT" e përfaqësuar nga Rektor Prof. Dr. Ilo Mele, bien dakord të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumanshëm në funksion të zhvillimit institucional.

Neni 1

Bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve do të përfshijë:

- a. Shkëmbimin e personelit akademik për procesin mësimor;
- b. Shkëmbimin e pedagogëve, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarisë kërkimore shkencore;
- c. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe formuese;
- d. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);
- e. Shkëmbimin e literaturës shkencore;

f. Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin institucional.

Neni 2

Të dy institucionet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshme nga secili institucion. Për detajimin e bashkëpunimit në fushat e mësipërme (1/a-f) dhe ndjekjen e zbatimit të Marrëveshjes, realizohet nga i ngarkuari i Rektorit nga secili institucion.

Neni 3

Çdo nen i kësaj Marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet të dy institucioneve.

Neni 4

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy institucionet janë dakord për këtë. Nëse njëri prej institucioneve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara.

Mosrinovimi i kësaj Marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga institucioni i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe dhe pasi lexohet, firmoset nga personat përkatës.

Për Universitetin Politeknik të Tiranës

REKTOR

PROF. DR. ANDREA MALIQARI



Për Akademinë "IVODENT"

REKTOR

PROF. DR. ILO MELE

